

**FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVA**



PROPOZICIONET E GARAVE

Për Ligat e U-19 dhe U-17

Kampionati i Kosovës në Futboll 2017-2018

Gusht 2017

Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit, bazuar në nenin 33 p. 3 nën a), te Statutit të FFK-së, me datë 02.08.2017 aprovoi:

PROPOZICIONET E GARAVE Për Ligat e U-19 dhe U-17

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këto Propozicione, caktohet mënyra, organizimi dhe udhëheqja e garave të kampionatit të futbollit në Kosovë për rangjet garuese për U-19 dhe U-17.

Neni 2

Me garat e futbollit në rangjet U-19 dhe U-17, udhëheqin Komisioni i Garave të cilin e emëron dhe shkarkon Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

Neni 3

Garat kampionale të futbollit, për U-19 dhe U-17 do të zhvillohen sipas sistemit të Ligave, në të cilin do të marrin pjesë:

- Në Superligën e U-19, garojnë 16 ekipe,
- Në Ligën e parë të U-19, garojnë 16 ekipe,
- Në superligën e U-17, garojnë 12 ekipe.

Neni 4

Ekipe të U-19, garat për ndeshjet kampionale i zhvillojnë në dy rangje, në: Superligë 16 ekipe dhe në Ligën e parë me 16 ekipe.

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, vendosë për rastet në të cilat ekipet përkatëse të U-19ëve tërhiqen gjatë zhvillimit të garave.

Garat e U-19 janë plotësisht të pavarura nga garat e seniorëve dhe zhvillohen sipas kalendarit të posaçëm të përcaktuar me short.

Tri (3) ekipet e fundit (sipas sistemit vajtje-ardhje) në SUPERLIGË për U-19ë largohen nga kjo kategori dhe kalojnë në Ligën e parë, ndërsa ato i zëvendësojnë tri (3) ekipet e plasuara në vendin e parë, dytë dhe të tretë të Ligës së parë.

Nga Liga e parë largohen dy (2) ekipe më të dobëta, ndërsa ato do t'i zëvendësojnë dy ekipet e U-19 të Klubeve nga Liga e dytë (nëse garohet, dhe nëse ka 16 ekipe), apo ekipet e interesuara më kusht të licencimit të ekipit për atë rang garash.

Tek U-19 zhvillohet pjesa e rregullt e kampionatit në vjeshtë dhe në pranverë.

Kusht për numrin e ndeshjeve është edhe licencimi i ekipeve, në të kundërtën ky numër mund të lëvizë, dhe të jetë më i vogël.

Nëse një ekip i U-19, pa arsye nuk i zhvillon 3 (tri) ndeshje gjatë tërë kampionatit (vjeshtë – pranverë), përjashtohet nga garat e mëtejme.

Liga e U-17 organizohet me sistem të zhvillimit të ndeshjeve vajtje – ardhje për xhiro të rregullta (vjeshtë – pranverë).

Në fund të kampionatit nga Liga U-17 largohen 3 (tri) ekipet të cilat janë të plasuara në 3 vendet e fundit te tabelës, kurse vendet e tyre plotësohen me 3 (tri) ekipe po të kësaj grupmoshe fituese nga turneu i Play-offit i organizuar nga Lidhjet Rajonale.

Nëse një ekip i U-17, pa arsye nuk i zhvillon 3 (tri) ndeshje gjatë tërë kampionatit (vjeshtë – pranverë), përjashtohet nga garat e mëtejme.

Ekipet të cilat e humbin statusin e anëtarit të Ligës së U-17 pas përmbylljes së kompeticionit të zhvilluar, do vazhdojnë garat për një rang me të ulët, garat do të vazhdojnë në Lidhjet rajonale prej nga të njejtat gravitojnë dhe atë në Ligat përkatëse të U-17 të atij rajoni.

Neni 5

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, i emëron Komisionet përkatës të Garave në përbërje prej 3 anëtarëve, të cilat do të udhëheqin me gara .

Neni 6

Garat e futbollit të Kosovës zhvillohen me sistem të dyfishtë (vajtje - ardhje) sipas kalendarit të garave, të verifikuar nga Komiteti Ekzekutiv i FFK-së. Të gjitha ndeshjet zhvillohen sipas Rregullave ndërkombëtare të lojës së futbollit.

Neni 7

Ndeshja zhvillohet në fushën të cilën e përcakton ekipi nikoqir para fillimit të Kampionatit e cila duhet të jetë e pranuar për atë rang të garave nga komisioni për pranimin e fushave. Me kërkesë të posaçme të cilën duhet t'a aprovoj Komisioni i Garave lihet mundësia e ndryshimit të vendit (fushës) për atë ekip i cili nuk ka mundësi t'a zhvillojë ndeshjen në fushën e vet. Por, ai ekip është i obliguar ta përgatitë fushën për lojë dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për organizimin dhe sigurimin e ndeshjes.

Ekipi i cili nuk e përgatitë fushën për zhvillimin e ndeshjes (pastrimin nga të reshurat atmosferike, vizatimin me vija të dukshme etj., të njejtën e humb me rezultat zyrtar.

Neni 8

Garat e U-19 dhe U-17 janë plotësisht të pavarura nga garat e seniorëve dhe zhvillohen sipas kalendarit të posaçëm të përcaktuar me short.

Ekipi i U-19 dhe U-17 ndeshjet kampionale në kuadër të ligës apo të kupës do t'i zhvillon në fushën ku i zhvillon ndeshjet ekipi i seniorëve, e në raste të caktuara në fushë alternative por e cila duhet të pranohet nga Komisioni për inspektim të fushave dhe të aprovet nga Komisioni që udhëheq me gara.

Neni 9

Ndeshjet kampionale zhvillohen të shtunave, të dielave apo edhe ndonjë ditë tjetër nëse për këtë vendos komisioni i Garave.

Klubi nikoqir, për ndeshje të caktuar, mund të propozon të ndryshojë terminin (nga e shtuna në të diel apo anasjelltas apo orën e zhvillimit të ndeshjes), me kusht që për këtë të paraqesë kërkesë me shkrim (së bashku me arsyetimin përkatës) Komisionit të garave i cili është i obliguar që të njoftoj edhe klubin kundërshtar, 5 ditë para terminit të ri të ndeshjes.

Komisioni i Garave mund të vendos që ndeshja e paraparë për të shtunën apo të dielën të zhvillohet gjatë një dite pune, sipas marrëveshjes me shkrim të dy klubeve, të prezentuar në Komisionin i Garave së paku 5 ditë para zhvillimit të ndeshjes dhe e vërtetuar nga ana e Komisionit të Garave si dhe nëse nuk ka ankesa nga klubet tjera për atë ndeshje e cila mund të jetë e rëndësishme edhe për plasmanin e ndonjë ekipi tjetër.

Marrëveshjet e këtilla, nuk do të pranohen për ndeshjet e dy xhirove të fundit të garave kampionale.

Neni 10

Në interes të rregullësisë së garave, Komisioni i garave me pëlqimin e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, mund të vendos që ndeshjet e dy xhirove të fundit të kampionatit, të zhvillohen në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë.

Për kapitujt në vijim dhe qështjet tjera që kanë të bëjnë me gara, vlejné dispozitat e Rregullores së Garave:

- **SHTYRJA E NDESHJEVE,**
- **F U S H A T,**
- **Detyrat e organizatorit te ndeshjes,**
- **CAKTIMI I FUSHËS DHE FILLIMI I NDESHJES,**
- **PARAQITJA E PARË DHE IDENTITETI I LOJTARËVE** etj.

Neni 11

Të gjithë lojtarët që paraqiten në ndeshje, duhet të kenë në rregull librezën e garave për ndeshje. Nga librezja qartë duhet të shihet se është bërë kontrollimi mjekësor i tij dhe se është paguar anëtarësia si dhe është bërë licencimi i lojtarit. Kontrollimin mjekësor, lojtarët e bëjnë dy herë në vit - para fillimit të stinorit vjeshtor gjegjësisht stinorit pranveror, te mjeku specialist i medicinës sportive, i cili aftësinë e lojtarit e konstaton në librezën sportive të lojtarit.

Në qoftëse lojtari paraqitet në ndeshje pa kontrollimin e kryer mjekësor, pa anëtarësi të paguar, apo licencim, ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtar (3:0) në të mirë të ekipit kundërshtar, nëse nuk është arrit rezultat më i volitshëm për kundërshtarin, kurse ndaj lojtarit dhe klubit do të ngritet procedura dicitpline.

Neni 12

1. Lojtari i cili ka te drejten e paraqitjes per U- 19, në kampionatin 2017-2018, konsiderohet lojtari i cili ka lindur me 01.01.1999 e me i ri.

- Në ekipin e U-19 (mosha 17 - 19 vjeq) me te rinjet mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar -vulosur në FFK.

2. Lojtari i cili ka te drejten e paraqitjes per U- 17, në kampionatin 2017-2018, konsiderohet lojtari i cili ka lindur me 01.01.2001 e me i ri.

- Në ekipin e U-17 (mosha 15 - 17 vjeq) me te rinjet mund te aktivizohen me kontrollim special mjekesor i cili eshte vertetuar-vulosur ne FFK.

Në ndeshje mund të paraqiten vetëm lojtarët të cilët janë të evidentuar-licencuar në FFK.

KONTROLLIMI MJEKËSOR I LOJTARËVE

Neni 13

Secili lojtar në librezën e vetë sportive, duhet të ketë të shënuar kontrollimin mjekësor të kryer. Afati i vlefshmërisë së kontrollit mjekësor për lojtarë zgjatë 6 (gjashtë) muaj.

Kontrollimi special mjekësor për lojtar të rinjë – U-19 që do të luajnë për ekipin e Parë, vlenë 6 (gjashtë) muaj, ndërsa për U-17 që do të luajnë për ekipin U-19, vlenë poashtu 6 muaj dhe keshtu me rradhe per cdo kategori me te ulet te te rinjeve. Me kontrollimin mjekësor special, derisa ai është në fuqi, lojtari mund të luajë në të gjitha ndeshjet edhe në rast se afati i vlefshmërisë së kontrollimit të rregullt mjekësor i ka kaluar, Libreza e lojtareve duhet medoemos ta kete vulen me te cilen shifet se lojtari e ka kaluar testin mjekesor (ne te kunderten nuk ka te drejten e lojes).

Klubet janë të obliguara t'i përmbahen në tërësi Rregullores së garave sa i përket kontrollimit mjekësor dhe personelit mjekësor.

XXV. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 14

Çdo vendim që merret në përputhje me këto Propozicione të Garave, është obligativ për të gjithë, derisa dispozitat e këtyre Propozicioneve të mos ndryshojnë.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtyre Propozicioneve i bënë Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, në procedurën e njejtë si për aprovimin e tyre.

Neni 15

Për çështjet që nuk janë përfshirë në këto Propozicione, vlejné Rregullorja e Garave.

Rregullorja Disciplinore, aktet tjera normative të FFK-së, si dhe Rregulloret e lojës së futbollit, të UEFA-së.

Neni 16

Këto Propozicione u miratuan me 2 Gusht 2017.

Propozicionet e Garave hyjnë në fuqi ditën e ardhshme pas nënshkrimit të saj.

Prishtinë, 02.08.2017

Kryetari i FFK-së,
Fadil Vokrri

Sekretari i Përgjithshëm,
Eroll Salihu